

VENDIM
Nr.848, datë 5.8.2009

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË
SPITALIT USHTARAK, GJIROKASTËR, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515,
DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të spitalit ushtarak, Gjirokastrë, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë.

2. Në listën e pronave, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja, truall, prej 5 261.7 (pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një presje shtatë) m², e zënë nga spitali ushtarak, Gjirokastrë, pjesë e pronës nr.593 “Shtabi i Brigadës”.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha